



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.19/2018
Prishtinë, më 14.3.2018, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Dardan Molliqaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

E ftuar: Leonora Kryeziu, drejtoreshë e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS).

Pjesëmarrës të tjerë: Diona Kusari-PIPS; Agnesa Haxhiu-KDI; Dardan Abazi-INDEP; Detjan Hulaj- ICHAT; Amire Qamili- BIRN; dhe Mehmet Krasniqi-Ekonomia Online.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datës 6.3.2018;
- 3.Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
4. Diskutim lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e kompetencave të parlamenteve të Evropës Juglindore mbi eficientë e energjisë, të ftuar OJQ PIPS;
- 5.Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 6.3.2018

Procesverbali i mbledhjes së datës 6.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetarja, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, andaj kërkoi që të votohet raporti me rekomandime, në mënyrë që të shkojë në lexim të dytë.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1.Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4. Diskutim lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e kompetencave të parlamenteve të Evropës Juglindore mbi efijencën e energjisë

Kryetarja i njoftoi anëtarët komisionit, se lidhur me këtë pikë të rendite të ditës, me kërkesë të saj, e kemi të ftuar znj. Leonora Kryeziu, drejtoreshë e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS), për të na njoftuar lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e kompetencave të parlamenteve të Evropës Juglindore mbi efijencën e energjisë, të cilës ia dha fjalën për ta prezantuar projektin.

Leonora Kryeziu, i falënderoi anëtarët e komisionit për mundësinë e dhënë për të prezantuar projektin që e ka Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e kompetencave të parlamenteve të Evropës Juglindore mbi efijencën e energjisë. Më tej, tha se projekti vjen si rezultat i bashkëpunimit me GIZ-in gjerman për promovimin sa më të madh të fushës së efijencës së energjisë. Ajo theksoi se për 8 vite që kur është themeluar Instituti i Prishtinës për Studime Politike, deri tani kanë punuar në 3 faza për politikën e efijencës së energjisë: Faza e parë ka qenë bashkëpunim me ministritë përgjegjëse dhe Kuvendin, për hartimin e infrastrukturës ligjore, faza e dytë bashkëpunim me shoqërinë civile për promovimin sa më informues për publikun, dhe faza e tretë, bashkëpunim me komunat për zbatimin në terren të fushës mbi efijencën e energjisë. Kërkoi përkrahje nga deputetët për bashkëpunim rajonal për formimin e Grupit të të Gjelbërve edhe në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, tha se qëllimi është që të nxisim shkëmbimin e përvojave me deputetët e parlamenteve të shteteve të rajonit. Ajo theksoi se nëse themelohet Grupi i të Gjelbërve në Kuvendin e Kosovës, atëherë një adresim i tillë i gjendjes së efijencës së energjisë do të ishte i mirëseardhur, pasi që ka mungesë të informacionit në këtë sektor. Znj. Kryeziu i njoftoi anëtarët e komisionit se gjatë

vitit 2018, PIPS ka në plan të punës organizimin e disa aktiviteteve informuese, duke përfshirë edhe mbajtjen e një tryeze të përbashkët me komisionin mbi efikasitetin e energjisë.

Kryetarja falënderoi znj. Kryeziu për prezantimin e projektit të Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS). Ajo tha se pasi që pritet të organizohet një tryezë e përbashkët, aty mund t'i diskutojmë gjërat më gjatë për këto çështje të propozuar, por edhe për bashkëpunim ndërparlamentar me shtetet e rajonit, sa i përket efikasitetit të energjisë. Po ashtu, premtoi se kur të kemi, si komision, shqyrtimin e Projektligjit për efikasitetin e energjisë, do të bashkëpunojmë ngushtë me PIPS-in..

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të ketë bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Prishtinës për Studime Politike (PIPS), për projektet e efikasitetit të energjisë.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetarja propozoi që të ftohet z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, për të raportuar në komision për zbatimin e Ligjit për Trepçën, konkretisht për Bordin e Trepçës, që ende nuk është emëruar dhe për gjendjen në të cilën gjendet ndërmarrja “Trepça”.

Mimoza Kusari- Lila, tha se pajtohet me propozimin kryetares për ta ftuar ministrin e MZHE-së, për të raportuar. Po ashtu, kërkoi që të raportohet edhe lidhur me Postën dhe Telekom-in e Kosovës, pasi që edhe në këtë ndërmarrje publike kemi probleme financiare.

Daradan Sejdiu, tha se pajtohet plotësisht me propozimet e kolegëve, pasi që humbjet financiare janë të mëdha, si në Postë, ashtu dhe në Telekom. Propozoi që të fillohet edhe me monitorimin e Ligjit për Trepçën dhe të formohet grupi punues.

Hykmete Bajrami, tha se pajtohet me propozimin që të ftohet ministri z.Valdrin Lluka, për të raportuar për çështjet e ngritura, ndërsa lidhur me propozimin për monitorimin e Ligjit për Trepçën, kërkoi të shtyhet, derisa të përfundohet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike.

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohet për raportim, z.Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, lidhur me gjendjen në Trepçë, Postë dhe Telekom.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

**E përgatiti:
Njësia për mbështetjen e komisionit.**

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA